



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Më datë **04.09.2014** Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të paparalajmëruar në SP për Kontroll Kufitar në Qafë Thanë. MPN-ja realizoi vizitë të **paparalajmëruar** në Stacionin Policor për Kontroll Kufitar në Qafë Thanë me qëllim të përcaktimit të gjendjeve dhe kushteve në vendet ku personat privohen nga liria dhe trajtimit të tyre. Qëllimi i vizitës u përcaktua në përputhje me mandatin i cili buron nga Protokollin Fakultativ Kundër Torturës dhe Llojeve të tjera të Trajtimit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues. Me Protokollin Fakultativ definohet se qëllimi i vizitave të rregullta në vendet ku personat privohen nga liria është identifikimi i rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës ose llojeve të tjera të trajtimeve brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

SP për Kontroll Kufitar në Qafë Thanë nuk është caktuar në përputhje me Aktvendimin për stacion policor ku ndalohen personat e privuar nga liria, megjithatë ka autorizim të privojë nga liria persona të cilët janë në kërkim, përkatësisht për të cilët është lëshuar urdhër-arrest apo nëse bëhet fjalë për persona të cilët në mënyrë ilegale kanë hyrë në shtet.

Ekipi i MPN-së, gjatë vizitës parandaluese, u informua se personat e privuar nga liria përkohësisht qëndrojnë në zyrën e udhëheqësit të turnit, ndërsa kur ekziston dyshimi se personi është kryerës i veprës së rëndë penale i njëjti ndalohet në ambient të veçantë (i cili shfrytëzohet vetëm për ndalime të përkohshme). Ky stacion policor ka edhe ambient të veçantë për azilkërkuar dhe migrantët kështu që personat e huaj vendosen në ambientin e njëjtë për periudhën derisa të sigurohet transporti deri në Qendrën e Pranimit për të Huaj në Shkup.

Në rast të arrestimit të shtetasit të huaj gjithmonë informohet sektori kompetent i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Personi i arrestuar, me bashkëngjitje të vërtetimit, i dorëzohet personit zyrtar të stacionit policor Strugë (ose stacionit tjetër policor kompetent).

Gjatë vizitës, ekipi i MPN-së u njoftua se personat çdoherë informohen për të drejtat e tyre dhe kjo ndodh në momentin e privimit në stacionin policor. Në përputhje me informatat e pranuar nga udhëheqësi i turnit, në rast të privimit nga liria, personi njoftohet me shkaqet e privimit dhe udhëzohet për të drejtat e tij. Komunikimi me personat e privuar nga liria, të cilët janë shtetas të huaj, bëhet në gjuhën angleze ose në gjuhë tjetër të cilët e flasin nëpunësit policorë (gjuhën shqipe). Njëkohësisht, ky SP detyrimisht e njofton organin kompetent pranë MPB-së për privimin nga liria të personit të huaj me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme.

Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi raport të veçantë për realizimin e vizitës në të cilin u konstatuan gjendjet pozitive dhe negative dhe u dhanë rekomandime përkatëse adresuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komandantit të SP KK Qafë Thanë.